**PROJEKT**

**MARRËVESHJE E BASHKIMIT TË SHOQËRIVE NËPËRMJET PËRTHITHJES**

**SHOQËRIA "ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION"SH.P.K.**

| | |
|---|---|
| **Forma Juridike:** | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar |
| **Selia:** | Tirane Kashar MEZEZ Njesia nr.11, rruga Gjergj Kastrioti Skenderbeu, ndertesa 3, hyrja 3, kodi postar 1050. |
| **Kapitali Themeltar:** | 4,300,000.00 LEKE |
| **Pjese e kapitalit:** | 100% |
| **ORTAKET:** | Z.Aurel Nezhaj zoteron 100% te kapitalit. |
| **NIPT** | L42021006L |
| **Administrator:** | Z.Aurel Nezhaj |

**SHOQËRIA PËRTHITHËSE**

**DHE**

**SHOQËRIA "A2 Engineering"SH.P.K.**

| | |
|---|---|
| **Forma Juridike:** | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar |
| **Selia:** | Tirane Kashar KASHAR Rruga, Gjergj Kastrioti Skenderbeu, Nr.3, H.3. |
| **Kapitali Themeltar:** | 100,000.00 LEKE |
| **Pjese e kapitalit:** | 100% |
| **Ortaku:** | Shoqeria "ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION" shpk |
| **NIPT** | M11706015V |
| **Administrator:** | Z.Aurel Nezhaj |

**SHOQËRIA E PËRTHITHUR**

**Bien dakort për sa vijon:**

## 1. OBJEKTI I MARRËVESHJES

Objekt i kësaj Marrëveshje është bashkimi nëpërmjet përthithjes i shoqërisë se Perthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k nga shoqeria Perthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" shpk.

Në këtë operacion bashkimi shoqëria "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" shpk do të jetë shoqëria përthithëse ndërsa shoqeria "**A2 Engineering**" sh.p.k do të jetë shoqëria e përthithur.

**Objekti i veprimtarisë për shoqërinë Perthithese "ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION" shpk është:** Tregti, import - eksport, me shumice e pakice te pajisjeve elektronike, elektro-shtepiake, te ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit te klimes, impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV, si dhe servisin e tyre, servis kompjuterash dhe pajisje telekomi, pajisje hidrosanitare, bar - bufe- restorant - hoteleri, mallra industriale, konfeksione, materiale ndertimi. Tregti me shumice dhe pakice i pajisjeve dhe sistemeve per mbrojtjen nga zjarri dhe sistemeve te tjera sigurimi dhe detektimi. Punime germimi ne toke. germimet, sistemimet dhe ndryshimet ne volum te tokes. Ndertime civile e industrial si dhe shit-blerja e tyre. Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash. Rruge autostrada, ura, mbikalime. Hekurudha, linja tranvai, metro, hekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale. Punime nentokesore, perfshire galerite natyrore, shpime, kalime nentokesore, tunele. Diga dhe tunele hidroteknike. Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje. Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje. Punime mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime. Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike. Ndertime, mirembajtje, ose ristrukturime me nderhyrje te sakta ose qe jane te nevojshem per prodhimin e energjise elektrike, te kompletuar me punimet e muratures, plotesuese ose ndihmese, te vecanta ose te rrjetit, perfshire edhe te gjithe impiantet mekanik, elektromekanik, elektrik, telefonik, elektronik, te nevojshem per funksionim, sigurim dhe asistence. Perfshin hidrocentralet dhe termocentralet. Ndertime per nenstacione, gabinat e transformacionit linjat e TVN dhe tensionit te mesem dhe shperndarjen e energjise elektrike. Punime te inxhinjerise mjedisore. Punime per prishjen e ndertimeve, impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit. Montimi dhe mirembajtje, ose ristrukturimi i nje sistemi te plote, sido qe te jete shkalla e rendesise se tyre, te ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit te klimes, te impianteve pneumatik, te kompletuar me punimet murature, plotesuese ose ndihmese, per te realizuar bashkimet ose nderhyrjet qe i perkasin kategorive te pergjithshme qe jane realizuar ose jane ne proces realizimi. Projektim dhe zbatim i sistemeve per mbrojtjen nga zjarri dhe sistemeve te tjera sigurimi dhe detektimi. Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV, Montimi, mirembajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV si edhe te linjave te trasmetimit te ngjashme me to e kompletuar me cdo punime te lidhur me muraturen, plotesuese ose ndihmese, per tu realizuar, te ndara nga zbatimi i sistemeve te tjere qe jane realizuar ose jane duke u realizuar ne punimet e pergjitheshme. Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre. Montimi, mirembajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare te kuzhines, lavanterise te gazit dhe kundra zjarrit, sado qe te jete shkalla e rendesise se veprave, e kompletuar me punimet e muratures plotesuese ose ndihmese, qe jane realizuar ose jane duke u realizuar ne punimet e pergjitheshme. Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese, transportues). Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut. Sinjalistika rrugore jo ndricuese. Barriera dhe mbrojtje rrugore. Ndertime parafabrikat me beton te armuar, struktura metalike dhe druri. Punime strukturore special. Shtresa dhe mbistruktura speciale. Punime ne shina dhe traversa. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. Pastrimi i ujrave detar, liqenore dhe lumore. Ndertimi i impianteve.te ujit te pishem dhe pastrimit te tij. Punime topogjeodezike. Sistemi i mbojtjes nga zhurmat ne infrastructure. Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per

uje. Shoqeria munde te bashkepunbje edhe me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem nga i saj. Shoqeria ka te drejte te shtoje objektin e veprimtarise se saj, ne cdo kohe sipas ligjeve ne fuqi. Dhënie e mjeteve dhe automjeteve me qera.

**Objekti i veprimtarisë për shoqërinë e Perthithur "A2 Engineering"shpk eshte**: Tregti, Import – eksport, me shumicë e pakicë të pajisjeve elektronike, elektro-shtëpiake, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, Impiante të brëndshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV, si dhe servisin e tyre, servis kompjuterësh dhe pajisje telekomi, pajisje hidrosanitare, bar – bufe- restorant – hoteleri, mallra industriale, konfeksione, materiale ndërtimi. Tregti me shumicë dhe pakicë i pajisjeve dhe sistemeve për mbrojtjen nga zjarri dhe sistemeve të tjera sigurimi dhe detektimi. Punime gërmimi në tokë. gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, Ndërtime civile e industrial si dhe shit-blerja e tyre. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash. Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tranvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Punime nëntokësore, përfshire galeritë natyrore, shpime, kalime nëntoksore, tunele. Diga dhe tunele hidroteknike. Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje. Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë. Punime mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime. Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjise elektrike. Ndërtime, mirëmbajtje, ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose që janë të nevojshëm për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshire edhe të gjithë impiantet mekanik, elektromekanik, elektrik, telefonik, elektronik, të nevojshëm për funksionim, sigurim dhe asistencë. Përfshin hidrocentralet dhe termocentralet. Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Punime të inxhinjerisë mjedisore. Punime për prishjen e ndërtimeve, Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionmit. Montimi dhe mirëmbajtje, oseristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatik, të kompletuar me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi. Projektim dhe zbatim i sistemeve për mbrojtjen nga zjarri dhe sistemeve të tjera sigurimi dhe detektimi. Impiante të brëndshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV, Montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to e kompletuar me çdo punime të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjerë që jane rëalizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme. Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre. Montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë të gazit dhe kundra zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme. Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues). Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese. Barriera dhe mbrojtje rrugore. Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri. Punime strukturore special. Shtresa dhe

mbistruktura speciale. Punime në shina dhe traversa. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. Pastrimi i ujrave detar, liqenore dhe lumorë. Ndërtimi i impianteve të ujit të pishëm dhe pastrimit të tij. Punime topogjeodezike. Sistemi i mbojtjes nga zhurmat në infrastructure. Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë. Shoqeria munde te bashkepunoje edhe me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem nga i saj etj.

Të dyja shoqëritë sa më lart, pra Shoqeria "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k dhe shoqëria "**A2 Engineering**"shpk, hartojnë këtë projekt marrëveshje nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjor, bazuar specifikisht në Nenet 215, 216, 225 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Bisnesitt".

Duke qenë se Shoqeria Perthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k është 100% Ortak i shoqërisë që do të përthithet Shoqeria "**A2 Engineering**" sh.p.k, ky bashkim me përthithje do të realizohet bazuar në këtë Marrëveshje.

## 2. MOTIVET DHE QËLLIMI I BASHKIMIT

Bashkimi nëpërmjet përthithjes i shoqërisë "**A2 Engineering**" sh.p.k nga Shoqeria "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**"sh.p.k bëhet në kuadrin e riorganizimit të aktivitetit tregtar, përfshirë aktivitetin financiar dhe tregtar të Shoqerise Perthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k.

OBJEKTI i veprimtarisë së shoqërisë Perthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k do të përfshijë dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë se Perthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k.

## 3. AKTIVET DHE PASIVET

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi shoqëria e Perthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k do t'i transferojë shoqërisë Perthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k tërësinë e elementeve të aktivit dhe pasivit sipas bilancit kontabël të vitit që përfundoi më 31.12.2021, duke marrë në konsideratë edhe çdo ndryshim të ndodhur deri në momentin e përthithjes që është data 31.12.2021.

Shoqëria Përthithëse "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k dhe Shoqëria e Përthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k ka hartuar pasqyrat financiare të muajit që përfundon më 31.12.2021, të cilat paraqesin vlerën kontabël të aseteve dhe detyrimeve të shoqërise së përthithur më 31.12.2021, dhe do t'i bashkangjiten bilancit të shoqërisë përthithëse "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k.

Të gjitha marrëdhëniet kontraktuale të lidhura nga shoqëria e përthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k dhe që janë në fuqi në datën e përthithjes, transferohen te shoqëria përthithëse "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k., e cila merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga këto marrëdhënie kontraktuale.

## 4. DATA E PËRTHITHJES

Në aspektin juridik, data e përthithjes do të konsiderohet data e pranimit Zyrtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) dhe e lëshimit prej saj të Çertifikatës së Çregjistrimit të Shoqërisë së Përthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k. Efektet financiare dhe të kontabilitetit, përfshirë deklarimet për Zyrën e Punës dhe për Organet Tatimore do të zbatohen nga data 01.01.2022. Të gjitha operacionet e veprimtarisë pas datës 01.01.2022, do të kryhen nga shoqëria përthithëse "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**"sh.p.k. Pas kësaj date çdo e drejtë apo detyrim, çdo veprim financiar, ekonomik apo administrativ do të kryhet nga Kompania Perthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k dhe do të pasqyrohet në kontabilitet nga shoqëria përthithëse "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**"sh.p.k.

## 5. TË DREJTAT DHE DETYRIMET ME PALËT E TRETA DHE ME INSTITUCIONET SHTETËRORE

Pas datës së përthithjes, Shoqeria "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k merr çdo të drejtë e detyrim që ka patur shoqëria e përthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k. në marrëdhëniet me të gjithë personat fizikë apo juridikë si dhe institucionet shtetërore, si organet tatimore vendore dhe qendrore, përfshirë Qendrën Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Regjistrimit të Automjeteve, Zyrën e Punës, etj.

Shoqeria Perthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k do të jetë përgjegjëse për ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgjegjësive financiare, juridike dhe administrative me organet tatimore qendrore dhe vendore deri në çregjistrimin prej tyre të shoqerise se Perthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k.

## 6. KAPITALI THEMELTAR

Duke qenë se Kompania Perthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k është 100% ortak i shoqërisë që do të përthithet Shoqeria "**A2 Engineering**" sh.p.k., ky bashkim me përthithje nuk do të sjell ndryshim ne Kapitalin Themeltar të shoqërisë përthithëse.

## 7. TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA

Ky bashkim me përthithje nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë për ortaket, duke qenë se shoqëria përthithëse "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**" sh.p.k është 100% Ortake e shoqërisë së përthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k.

## 8. MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

Punëmarrësit e shoqërisë së përthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k. do të transferohen në shoqërinë përthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**"sh.p.k, nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të reja të punësimit.

Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, shoqëria e Perthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k. dhe shoqeria Perthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**"sh.p.k, do të deklarojnë në organet tatimore respektive dhe në Zyrën e Punës largimin nga puna të punonjësve të Shoqerise se Perthithur "**A2 Engineering**" sh.p.k. dhe marrjen e tyre në punë nga Shoqeria Perthithese "**ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION**"sh.p.k.

**Shoqeria Perthithese**
**"ALBANIA ENGINEERING CONSTRUCTION"** shpk

Administratori:
Z.Aurel Nezhaj

**Shoqeria e Perthithur**
"**A2 Engineering**" sh.p.k

Administratori
Z.Aurel Nezhaj

**Hartuar në Tiranë më datë 16.09.2022**